

ALFABETI I NAUM VEQILHARXHIT NË KONTEKSTIN BALLKANIK DHE EVROPIAN

Gjystina Cacaj-Shushka
Beograd

KUD 809.148.3-3
Punim studimor

Marrë për botim, 26.II.1997

*"Unë përpiqem vetëm të bëj të shkruhet
gjuha e kombit."*

Naumi

Në shekujt XVIII e XIX në Shqipërinë e Jugut zhvillohej një veprimtari e dendur kulturore arsimore, që përfshinte mbarë qytetet e kësaj pjese bashkë me Vithkuqin. Bëhej një punë e veçantë për përkthimin e përshtatjen e veprave fetare e gjithnjë shtohesh interesimi për shkrimin e gjuhës shqipe me qëllim që të viheshin themelet e shkrimit shqip.

Kur iluministët ballkanas të shekullit XIX bënë përpjekje për ta shkruar gjuhën amtare, dhe përcaktoheshin për një alfabet të caktuar, siç ishte rasti me rumunët dhe popujt sllavë, Naum Veqilharxhi përpiqej të gdhente një alfabet që do të pasqyroste strukturën fonetike të gjuhës shqipe dhe të kishte karakter gjithëkombëtar.

Duke u gjendur në mesin e shumë të mërguarve prej kombesh të ndryshme të Ballkanit, të vendosur në Rumani, Naum Veqilharxhi u gjend, jo vetëm në qendër të ideve përparimtare, por edhe në vatrën e iluminizmit. Në këtë veprimtari shquheshin Jon Heliade Radulescu (Eliade Radulesku), George Baritiu (Gjorgji Bariciu) e Gheorghe Lazar (George Lazer) ky i fundit i njohur si themelues i shkollës së parë në gjuhën rumune. Këtij rrethi i takonte edhe iluministi i njohur bullgar Ivan Seliminski, që dihet se ishte mik i

Naum Veqilharxhit,¹ Petër Beroni (Петер Беран) si dhe shumë iluministë të tjerë të Ballkanit.

Miqësia dhe bashkëpunimi me të gjithë ata për të cilët lëvrimi dhe shkrimi i gjuhës amtare ishte gjëja thelbësore e kulturës kombëtare, ushtruan ndikim në formimin e vetëdijës së Veqilharxhit në përgjithësi, si dhe në punën e mëtejshme të autorit tonë. Kështu duke njohur punën iluministe të prijësve të kombeve të tjera, si të Dimitër Daruvarit, që tanimë kishte botuar abetaren në gjuhën greke, të Gheorghe Lazar (Georgi Lazer), arsimdashës rumun, i cili më 1820 botoi abetaren e parë në gjuhën rumune, të Petër Beronit (Петер Беран) që më 1824 botoi në Brashovë abetaren e bullgarishtes si dhe të Vuk Karaxhiqit (Vuk Karadžić), i cili më 1827 botoi abetaren e gjuhës serbe në Vjenë, edhe Naum Veqilharxhi ynë iu përvesh punës së krijimit të alfabetit të shqipes. Ai gjithnjë e kishte të qartë "lidhmërinë ndërmjet arsimit dhe gjuhës kombëtare." Kështu, sipas programit të Veqilharxhit, siç thotë prof. Qosja, "... arsimi do t'i njihet dinjiteti në qoftë se është arsim në gjuhën kombit."² Lidhur me këtë në Enciklikën e vet, ku shiheshin parimet e qëllimet e punës së gjithmbarshme të Naumit, ai shkruan: "... ato kombe që mbetën në padije, u shëmbëlleshin thjesht skllëvërve ... këto mund të dalin nga gjendja e turpshme e mjerimit të tyre, kur të fillojnë të lëvrojnë gjuhën e tyre kombëtare."³

Duke pasur parasysh se populli shqiptar ka një histori me të gjitha veçoritë kombëtare dhe se gjuha shqipe dallohet nga gjuhët e tjera për nga tiparet e veçanta të natyrës së saj si edhe duke ndjekur traditën e të parëve që bëjnë përpjekje (që nga shekulli XVII) për përpilimin e një alfabeti të veçantë për gjuhën shqipe, Naum Veqilharxhi me alfabetin e vet vuri themelet e kulturës dhe të arsimit në gjuhën shqipe në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Në kohën e vlimeve revolucionare në Ballkan, kohë kur çdo popull bënte përpjekje të arrinte çlirimin kombëtar, alfabeti i krijuar nga Naum Veqilharxhi pati një jehonë më të madhe, sepse ai me punën e vet dëshmoi edhe një herë praninë e kombit shqiptar në trevat ballkanike.

Naum Veqilharxhi ashtu si bashkëkohësit e tij ballkanas për krijimin e alfabetit të veçantë për gjuhën amë ndoqi rrugën e iluministëve të shekullit XIX duke zbatuar kryesisht parimin fonetik (një shkronjë për një tingull) dhe hodhi poshtë metodën e vjetëruar në përvetësimin e shkrim-leximit që në atë kohë po deprimonte vështirë nga Evropa e civilizuar.

Alfabeti i N. Veqilharxhit karakterizohet nga mbizotërimi absolut i shkronjave të thjeshta dhe të njëvlershme. Nga 36 shkronja që përdor, 31 janë

¹ Dhimitër Shuteriqi, "Nëntori", Nr.4/1974, f.60.

² Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, Romantizmi II, Prishtinë, 1984, f.20.

³ Shih. Letër enciklike ... në Myslim Islami, Naum Veqilharxhi - Ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare, Tiranë, 1977, f. 155-156.

të thjeshta dhe vetëm 5 shkronja janë të përbëra, konkretisht shkronjat që shënojnë tingujt y, q, sh në vete përmbajnë nga një shenjë diakritike për t'u dalluar nga u, k, dhe s-ja \check{y} , \check{q} , \check{sh} kurse shkronjat gj dhe zh janë digrame, sh , zh .

Nga 36 shkronja të alfabetit të Veqilharxhit 35 janë të njëvlershme, ndërsa shkronja që shënon tingullin ç/ \check{c} / është polivalente dhe përdoret për të shprehur edhe tingullin xh.

Këto veçori të alfabetit të Naum Veqilharxhit përbëjnë edhe arritjen më të rëndësishme në sistemin grafik të autorit tonë (po jo vetëm të tij) në krahasim me traditën e shkrimeve të vjetra shqipe që karakterizoheshin nga përdorimi i grafemave të përbëra dhe shumëvlerëshë, parim ky që ndiqnin në këtë drejtim edhe iluministët e tjerë ballkanas.

Si përfundim shihet se me sistemin fonetik të alfabetit të N. Veqilharxhit shprehet pothuajse gjithnjë sistemi fonetik i gjuhës së sotme letrare duke përjashtuar shkronjën rr, e cila në alfabetin e Naumit në të gjitha rastet përfaqësohet me shkronjën r. Kjo dukuri shpjegohet me mungesën e fonemës rr në sistemin fonologjik të së folmes së rrethinave të Korçës ku bën pjesë edhe e folmja e Vithkuqit.

Alfabeti i Naum Veqilharxhit me grafi specifike dhe forma të një elegance të matur ngriti alfabetin e gjuhës shqipe "në një shkallë më të lartë të shqyrtimit shkencor."⁴

Ngritjen e nivelit kulturor të kombit shqiptar Naum Veqilharxhi gjithnjë e mbështet në modele të kombeve të përparuara. Shi për këtë flet edhe George Baritiu (Gjorgji Bariciu), themelues i shtypit rumun në Transilvani, në "Gazeta de Transilvania" të Brashovit ku më 1845 shkruan: "... shekulli XIX, ky shekull i dritave, zgjon edhe midis shqiptarëve një burrë ... i cili radhit një alfabet të përshtatshëm, harton një filladhe, të cilën edhe e shtypi."⁵

Po në këtë gazetë George Baritiu (Gjorgji Bariciu) botoi një artikull që sjell një lajm nga Lajpcigu mbi interesimin që zgjoi alfabeti dhe vepra e N. Veqilharxhit te filologët gjermanë. Midis tjerash Baritiu (Bariciu) shkruan: "Burra shqiptarë, përqafoni këtë fryt të paçmuar të paqes, mblidhni edhe ju në gjirin tuaj shkencat dhe artet e bukura."⁶ Kësaj përkrahjeje i bashkohet edhe Jon Eliade Radulescu (Radulesku) në gazetën që e drejtonte vetë "Curierul Rumanesc" (Kurierul Rumanesk), sidomos në artikullin "Mbi shqiptarët", botuar më 1846 në Bukuresht, shkruan me ngrohtësi për popullin shqiptar edhe për veprën e N. Veqilharxhit ku thekson se "Përpyekjet e Naumit mund të

⁴ P a j a z i t N u s h i, *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptivë e përmasat e lexueshmërisë të shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 39.

⁵ M a h i r D o m i, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, f. 14.

⁶ M. D o m i, *Mbi jehonën e botimit të abetarit shqip dhe të veprimtarisë së N. Veqilharxhit në shtypin rumun të kohës*, SF., Nr.4, Tiranë, 1976, f. 120-121-125.

konsiderohen te ky popull si një simbol kombësie, rreth të cilit mund të mblidhen të gjitha pjesët e shpërndara prej aq shekujsh," duke i ftuar shqiptarët "t'i shtrijnë dorën vëllait të tyre që po sakrifikohet për ta."⁷

Përkrahja që i dhanë Naum Veqilharxhit personalitetet më të shquara të kulturës rumune, qartëson edhe një herë brumosjen e ideve të përbashkëta të përfutuara nga kushtet e ngjashme historike dhe traditën e krijuar shekuj me radhë midis dy popujsh. Midis miqve të Naumit duhet përmendur edhe iluministin dhe prijësin e lëvizjes kombëtare bullgare I.Seliminski. Duke pasur parasysh bashkëpunimin kulturor të N. Veqilharxhit me iluministët ballkanas, autorin tonë nuk mund të ndajmë nga arritjet e tërësishme të kulturës së Ballkanit dhe më gjerë. Kështu shkencëtari gjerman A. Auer në një përmbledhje kushtuar alfabeve e radhiti alfabetin e Veqilharxhit midis 104 alfabetesh⁸ nga e njohu edhe Johann Georg von Hahn-i, i cili lidhur me këtë alfabet më 1854 shkroi se "Germat e Naum Veqilharxhit nuk janë primitive dhe të vrazhda, por të punuara me estetikë, të një stili elegant."⁹

Lidhja midis shqiptarëve të mërguar dëshmohej posaçërisht me rastin e kurorëzimit të sukseseve të punës së tyre. Me këtë rast po kujtojmë Jeronim De Radën, me të cilin Veqilharxhi hyri në lidhje duke i dërguar autorit të "Milosaos" disa ekzemplarë të Evetarit të parë (1844), të cilët De Rada do t'i ruajë deri më 1862, kur ia dërgoi Dhimitër Kamardës.¹⁰

Vinçenc Dorsa, po ashtu arbëresh i Italisë, pasi u njoh me alfabetin e Veqilharxhit këtë e quajti "Alfabet i ri" me shkronja speciale."¹¹

Për origjinën e alfabetit të Naum Veqilharxhit janë bërë studime dhe janë bërë vlerësime nga shumë studiues. Kështu, bie fjala Geitleri ka pohuar se alfabeti i Veqilharxhit ka një bazë sllave. Prof. Mahir Domi këtë pikëpamje e ka gjetur si të kuptueshme po ta marrim parasysh se rumunët, në mes të cilëve jetonte N. Veqilharxhi, përdornin në atë kohë alfabetin cirilik me disa shenja të posaçme për gjuhën rumune.¹²

⁷ M. D o m i, *Mbi jehonën e botimit të abetarit shqip të Naum Veqilharxhit ...*, f. 123 dhe 121.

⁸ A. A u e r, *Die Schriftzeichen des gesammten Erdkreises in 104 alphabeten*, Wien, 1847.

⁹ J o h a n n G . v o n H a h n, *Albanesische Studien*, 1854, f. 292-293; cit.sipas M.Islamit, Vep. e cit. f. 70.

¹⁰ Krahaso: Dhimitër S. Shuteriqi, *Mbi Veqilharxhin, fakte dhe hipoteza*, SF., Nr.4, Tiranë, 1976, f. 145.

¹¹ Su gli albanese ... Napuli, 1846, g. 131/cit. sipas M.Domit, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, f. 16.

¹² M. Domi, po aty. f. 18, shën.13.








Edhe Dhimitër Shuteriqi ka shkruar se alfabeti i Naum Veqilharxhit është me bazë sllave (kryesisht glagolike, më të moçmet germa sllave) e fytyruar edhe sipas alfabetit grek.¹³

Në punimin e vet "Naum Veqilharxhi për gjuhën letrare shqipe" Tomor Osmani, midis tjerash bën fjalë edhe për burimin e alfabetit të autorit tonë. Sipas mendimit të tij, "Naum Veqilharxhi nuk u mbështet as në alfabetin latin dhe as në alfabetin grek, por krijoi një alfabet të veçantë". Në vazhdim të studimit Tomor Osmani shkruan se se në alfabetin e N. Veqilharxhit "Ka ndonjë element nga alfabeti cirilik eklektiv slav (shkronja *a* dhe *j*) dhe cirilik sllav civil (shkronja *y*). Për ndonjë shkronjë ka elemente të veçanta të alfabetit cirilik edhe në stilin e hartimit të ndonjë shkronje ... Me gjithatë këto janë elemente të pakta dhe nuk mund të flasim për një ndikim të mirëfilltë të Naum Veqilharxhit dhe aq më pak për një bazë sllave. Alfabeti i tij mbetet alfabet i veçantë i gjuhës shqipe", përfundon Tomor Osmani.¹⁴

Duke u nisur nga këto pohime ne kemi bërë një krahasim të alfabetit të N. Veqilharxhit me alfabetin glagolik dhe kemi arritur në përfundim se pikat e përbashkëta janë shumë të pakta ose të papërfillshme.

Zvonimir Kulundzic (Kulunxhiq) në veprën "Historija pisama" shkruan se në shekullin XVIII e XIX u krijuan disa alfabete për gjuhën shqipe, që patën përdorim të kufizuar dhe, si duket, "janë krijuar si derivate të kursivit grek, me modifikime, redukime dhe shtime të ndryshme". Ndër ta përmend edhe alfabetin e Veqilharxhit, të cilin e quan "Bitakukjev alfabet", i përbërë, sipas tij, nga 32 shenja, për të cilin di se e paska krijuar një shqiptar më këtë mbiemër (që do me thënë Alfabeti i Vithkuqarit).¹⁵

Johannes Friederich më 1966 ka shkruar se alfabeti i Naum Veqilharxhit përfaqëson një modifikim e stilizim të vonshëm të alfabetit të greqishtes së re me disa shenja të serbishtes.¹⁶

Në tabelën e dhënë nga J. Friederich janë paraqitur 32 shenja. Në mungon shenja grafike  e cila përfaqëson vlerën fonetike të tingullit //l/. Në transkriptim J. Friederich ka dhënë, sipas hulumtimeve tona, edhe shpjegime të mangëta në vlerësimin fonetik të grafemave. Autori, midis tjerash, jep të njëjtën vlerë fonetike për shenjën  dhe  e që në alfabetin e Naumit dalin me vlera të ndryshme fonetike *c*, *x*. Kështu vepron edhe për shenjën grafike  (*dz*) = *z*,  (*v*) = *s*,  dhe . J. Friederich i transkripton të

¹³ Dh. S. Shuteriqi, Mbi Barletin e shkrime të tjera, Tiranë, 1979, f.9. Shih edhe M. Domi - S. Mansaku, Abetarja e N. Veqilharxhit shprehje e parë e shumanshme e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, "Studenti", Tiranë, 30.3.1984.

¹⁴ Tomor Osmani, *Studime filologjike*, Nr.2/1987, Tiranë, f. 139-140.

¹⁵ Zvonimir Kulundžić, *Historija pisama*, Zagreb, 1957, f. 587.

¹⁶ J. Friederich, *Geschichte der Schrift*, Herdelberg, 1966, cituar sipas botimit në rusisht "Москва", 1979, f. 146; dhe f. 371 PNC. 252.

parën me *h*, kurse të dytën, vlerën e së cilës Naumi e shënon me χ = në greke, ai e ka kuptuar si *x*=iks romake. Të gjitha mangësitë në përcaktimin e vlerës fonetike të alfabetit të Naum Veqilharxhit, J. Friederich mund t'i ketë bërë nga mosnjohja e gjuhës shqipe.

Deri në diët tona ka munguar një studim tërësor për këtë alfabet. Nga krahasimi që kemi bërë me alfabetin e armenishtes del, sipas nesh, se ka disa afërsi të dukshme grafike me vlera të njëjtë fonetike midis këtyre dy alfabeteve. P.sh.: grafema \mathcal{U} që në armenishte shënon tingullin -a është grafikisht e ngjashme me grafemën \mathcal{C} , që po ashtu shënon tingullin -a në alfabetin e Veqilharxhit. Po kështu mund të vërehen afërsi të varianteve të grafemave: \mathcal{V} = *v* të armenishtes me grafemën \mathcal{Y} = *v* të alfabetit të N. Veqilharxhit, varianti \mathcal{U} = *k* është i afërt me \mathcal{A} = *k* në alfabetin Naumit; grafema \mathcal{V} = *m* e armenishtes është e ngjashme me grafemën \mathcal{S} = *m* në alfabetin e Veqilharxhit; grafema \mathcal{Q} = *n* në armenishte është e afërt me grafemën \mathcal{H} = *n*, d.m.th. me të njëjtën vlerë fonetike; grafema \mathcal{U} = *se* e armenishtes mund të afrohet \mathcal{O} = *s* të alfabetit të Veqilharxhit; grafema \mathcal{Z} = *h* në armenishte është e afërt me variantin \mathcal{H} = *h* në alfabetin e Veqilharxhit. Nga krahasimi del se kemi edhe një variant të *h*-së grafikisht të ngjashëm dhe me vlerë të afërt fonetike në alfabetin e armenishtes me atë të N. Veqilharxhit, kështu grafema \mathcal{R} = *h* në armenishte i përgjigjet variantit \mathcal{C}^2 = *h*² në alfabetin e Naum Veqilharxhit.¹⁷

Mundësia e një ndikimi nga alfabeti i armenishtes në alfabetin e Naumit mund të shpjegohet me kontaktet që ka pasur Veqilharxhi me armenët në lagjen ku ka banuar në Braila brenda viteve 1834-1839, për çka gjejmë shënime në Arkivin shtetëror të qytetit të Brailas në Rumani. Qëndrimi i Naumit në lagjen e bashkësisë armene e ka ndihmuar që ai të ketë njëfarë pavarësie nga ndikimi grek.¹⁸

Gjithsesi problemi i burimit të alfabetit të N. Veqilharxhit mbetet i hapur.

Duke analizuar alfabetin e Naum Veqilharxhit dhe të bashkëkohasve të tij ballkanas, vërehen afërsi në sistemin e parimeve të mbarështrimit të shkronjave të alfabeteve të tyre. Duke pasur parasysh se "djali sa do i vogël të jetë, gjithë mundimnë e të rëndit do e ketë sa të nxërë shënimet e të foltmit, do me thënë "Evet", pasi "gjuhën e ka të lertë nga mëm'eti," N. Veqilharxhi rëndësi të posaçme i kushton mënyrës së përvetësimit të shkronjave dhe vlerës së tyre fonetike duke i radhitur në vend të parë zanoret e pas tyre bashtingëlloret. Të njëjtin parim ndjekin Gheorghe Lazar (George Lazer), Петар (Petër) Beroni dhe Vuk Karadzici (Karaxhiqi).

¹⁷ Shih për këto në:

¹⁸ V e h b i B a l a, *Të dhëna për figurën dhe veprën e Naum Veqilharxhit*, Buletini shkencor, viti X, 1973, Nr.2 (14).

Meqenëse iluministët ballkanas në shekullin XIX vinin themelet e shkrim-leximit në gjuhën amtare, konkretisht Veqilharxhi e Karaxhiqi për vlerën fonetike të shkronjave të alfabeve të reja japin sqarime të nevojshme duke përdorur, i pari (Naumi) kryesisht shkronjat gjegjëse të alfabetit grek, frëng, italian e ndonjëherë edhe gjerman, ndërsa Karaxhiqi vlerën fonetike të cirilikës së vet e sqaron me alfabetin latin, atë çek, hungar, gjerman etj. duke u mbetur besnik alfabeve të veta fonetike. Në fund Veqilharxhi jep sqarime për ndërtimin e digrameve $-gj = \text{Гг}$ dhe $-zh = \text{Жж}$ duke i ashtuar alfabetit të vet edhe dy shkronja, të cilat nuk janë paraqitur në tabelën e alfabetit fonetik të autorit tonë.

Alfabeti i veçantë për shqipen, përkatësisht Evetarët e Naum Veqilharxhit zgjuan interesim tek iluministët ballkanas, kolonitë shqiptare dhe Evropë, por përkrahje më të madhe gjetën në qytetet e Shqipërisë së Jugut, e posaçërisht në Korçë, Përmet, Vithkuq e gjetiu, ku alfabeti i ri për shqipen u fut në përdorim për të mësuar shkrim e lexim në gjuhën amë.

Me këtë rast intelegjenca korçare në letrën dërguar Naumit në Rumani, i shpreh nirenjohje për krijimin e shkronjave për gjuhën shqipe "prej të cilave kombi ynë ka qenë i privuar gjatë kaq shekujsh".¹⁹ Punën e Veqilharxhit korçarët e çmojnë si fryt të shenjtë me të cilin "kombi ynë do të numërohet me kombet e ndriçuara të Evropës", përfundojnë ata.²⁰

Me gjithë kontributin e madh që dha Naum Veqilharxhi për zhvillimin e arsimit filestar, me alfabetin që krijoi e që i përgjigjet plotësisht natyrës së gjuhës shqipe dhe strukturës fonologjike të saj, krahas jehonës dhe përkrahjes që pati, alfabeti i tij u përdor vetëm për një kohë të shkurtër. Me të nuk u botua asnjë libër tjetër, përveç dy Evetarëve (1844 dhe 1845), që Naumi "me të math nder e tërultm" ua fal "djelm(ve) nismëtorë" dhe çdo si cillë qëdo mpsonjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip.²¹

Duke pasur parasysh gjithnjë se kultura e një koombi kurrë nuk ka mundur të zhvillohet e ndarë nga gjithë arritja kulturore e njerëzimit, dhe se vetëm reciprokisht të lidhura njëra me tjetrën mund të jenë më të plota dhe të kenë zhvillim më të shpejtë, Naum Veqilharxhi me veprimtarinë e vet nuk u izolua asnjëherë nga bota e përparuar e kohës. Nga dashuria për njeriun dhe dëshira për emancipimin e tij, autori ynë synon të arsimohet mbarë populli dhe bëri përpjekje të mëdha për hapjen e shkollës në gjuhë amë.

¹⁹ Krahaso: P e t r a q P e p o, *Një letër e korçarëve e vitit 1845*, dërguar N. Veqilharxhit në Rumani, SF., Tiranë, Nr.1, 1996, f.203.

²⁰ M. I s l a m i, *Me përulje vllazërore*, citat f. 146.

²¹ G j y s t i n a S h u s h k a, *Vepra e Naum Veqilharxhit*, Prishtinë, Rilindja, 1994, f. 77 dhe 55.

Gjystina Cacaj-Shushka

THE ALPHABET OF NAUM VEQILHARXHI IN THE BALKANS AND EUROPEAN CONTEXT

Summary

Naum Veqilharxhi with the special alphabet for the Albanian language laid the foundations of culture and education in the mother tongue in the period of the National Renaissance.

For creation of this alphabet he mainly followed the phonetic principle (one letter for one sound), following so in this task the Balkans illuminists of the 19th century.

The alphabet of Naum Veqilharxhi expresses almost the whole phonetic system of the Albanian standard language. This alphabet aroused interest for Rumunian, Bulgarian, German and Austrian scholars. This alphabet was also studied by Italian and Yugoslav scholars, but its resound (echo) and the greatest support came from Albania and from the Albanian colonies.

The origin of this alphabet even nowadays remains uncertain, but from the comparison that we have made with the Armenian alphabet, according to our researches it comes out that there are some evident graphic similarities with the same phonetic values between these two alphabets.

The closeness of the work (task) of Naum Veqilharxhi with his Balkans contemporaries can be seen in the system of the principles of arrangement of letters of their alphabets and as well in giving necessary explanation about his letters with corresponding letters of other alphabets, of the Greek, Latin, French, German, alphabet etc.